



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“ANIMACION SOCIAL”

Niveli III në KSHK¹, referuar niveli III të KEK²

O3-III-16

Tiranë, Nëntor 2016

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	Animacion Social			Kodi
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	III në KSHK	O3-III-16
Qëllimi:	<p>Qëllimi i kualifikimit profesional “Animacion Social”, niveli III-të, në KSHK, referuar niveli III të KEK, është të përgatisë punonjës me të kualifikuar, që lidhen drejtpërdrejt me fushën e Animacionit Social dhe në shërbimet e ofruara nga këto fusha, të zhvillojë personalitetin e individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon, si dhe të zgjerojë njohuritë mbi teknikat e animacionit me qëllim lehtësimin e realizimit të objektivave në jetën profesionale</p>			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në “Animacion Social”, të nivelit të tretë në KSHK, referuar niveli III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kanë mbaruar dy vitet e para të arsimit profesional, në kualifikimin “Shërbime Social dhe Shëndetësore”, niveli II në KSHK, referuar niveli II të KEK; - janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Animacion Social”, niveli III në KSHK, referuar niveli III të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Supplementin përkatës të punonjësit të kualifikuar në këtë fushë, individit ka të drejtë të vazhdojë arsimimin në nivelin teknik/menaxher. Me arsimim të mëtejshëm ai fiton të drejtën për Diplomën e “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p> <p>Ky arsimim profesional i jep individit mundësi t’i drejtohet tregut të punës si animator social. Misionet e tij janë aq të shumëllojshme sa janë dhe problemet dhe kontekstet shoqërore duke plotësuar nevojat e njerëzve përmes krijimit dhe zbatimit të aktiviteteve që kontribuojnë si në zhvillimin e marrëdhënieve shoqërore, ashtu dhe për ruajtjen e një shëndeti të mirë fizik e mendor.</p> <p>Individi mund të punësohet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Strukturat e pushtetit vendor si: Bashkitë dhe Komunat; - Spitalet publike dhe private; - Shoqatat dhe OJF-të që operojnë me grupmosha (fëmijë, adoleshentë, moshë e tretë) dhe kategori të ndryshme (njerëz me aftësi të veçanta, në nevojë, etj.); - Agjencitë dhe bizneset private që operojnë në fushën e edukimit (kopsht, shkollë, shtëpi pritjeje për moshën e tretë) dhe të evenimenteve festive (ditëlindje, kampe verore dhe dimërore etj.); 			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	Nuk ka			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Individi duhet të dijë të:

Sfondi i përgjithshëm profesional në animacion

- Të përshkruajë natyrën dhe filozofinë e shërbimeve të animacionit social;
- Te përshkruajë rëndësinë e shërbimeve të animacionit social në zhvillimin e marrëdhënieve shoqërore, ashtu dhe për ruajtjen e një shëndeti të mirë fizik e mendor;
- Të përshkruajë natyrën e sjelljes njerëzore në një mjedis social;
- Të rendisë karakteristikat e një animatori social;
- Të shpjegojë një program të caktuar social sipas një grupi të caktuar të synuar;
- Të përshkruajë një program/projekt social;
- Të identifikojë grupmoshat dhe problemet e tyre;
- Të rendisë mjetet e punës dhe bazën materiale të nevojshme;
- Të përshkruajë organizimin në mënyrë ergonomike vendin e punës;
- Të përshkruajë mënyrën e përcaktimit të roleve sipas llojit të programit social;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e njohjes së legjislacionit në fushën e shërbimit social për një shërbim sa më cilësor dhe efikas;
- Të përshkruajë konceptet bazë të legjislacionit në fushën e shërbimit social;
- Të përshkruajë fazat e hartimit dhe zbatimit të një plani veprimi individual duke respektuar personalitetin e individit/grupit të asistuar;
- Të listojë disa argumente të nevojës së punës në grup;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e marrjes së vendimeve në një ekip dhe jo individuale;

Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit

- Të përshkruajë legjislacionin përsa i përket sigurisë së jetës në lidhje me aktivitetet e ndryshme sociale;
- Të identifikojë situatat e rrezikshme gjate një aktiviteti social;
- Të identifikojë një plan menaxhimi të rreziqeve të ndryshme në një aktivitet social;
- Të përshkruajë procedurat në lidhje me situatat emergjente të mundshme (zjarr, djegie etj.) dhe masat mbrojtëse ndaj tyre;
- Te përshkruajë procedurën e dhënies së ndihmës së parë;
- Të përshkruajë rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit;
- Të përshkruajë mënyrat e ndarjes së mbeturinave sipas llojit të tyre;
- Të përshkruajë rregullat e higjienës personale dhe të higjienës së vendit të punës;

Teknikë e animimit

- Te identifikojë elementet e formulimit të një objektivi dhe qëllimi për një aktivitet social;
- Të përshkruajë rëndësinë e planifikimit dhe respektimit të kohës së nevojshme për zbatimin e një projekti ose programi social;
- Të shpjegojë teknika ‘‘thyerje-akulli’’ (shaka, histori komike, etj.) me qëllim krijimin e një klime sa më të mirë bashkëpunimi;
- Të identifikojë teknika të ndryshme animimi në funksion të aktivitetit social në varësi të hapësirës në dispozicion;

Psikologjia

- Të vlerësojë progresin e një individi ose grupi shoqëror në një komunitet;
- Të interpretojë marrëdhëniet midis grupmoshave dhe komuniteteve të ndryshme;
- Të përshkruajë rëndësinë e njohjes së heterogjenitetit motivues dhe emocional të individëve;

Gjenerimi i ideve të reja të animacionit social

- Të përshkruajë format e ndryshme të teknologjisë për marrjen e informacionit në përputhje me programin;
- Të përshkruajë nevojën e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit;
- Të rendisë llojin e informacionit sipas nevojave dhe interesave të grupmoshave të caktuara;
- Të rendisë burimet e informacionit të nevojshme sipas tematikës/programit social;
- Të përshkruajë mënyrat e përpunimit të informacionit sipas tematikës/programit social;
- Të përshkruajë mënyrën e ruajtjes së informacionit;
- Të përshkruajë mënyrën e formatimit/përmbledhjes së informacionit të mbledhur;
- Të përshkruajë nevojën dhe mënyrën e raportimit;
- Të përshkruajë mënyrën e formulimit të propozimeve për modele, sfonde, grupe, karaktere, objekte dhe mjedisin animues, si dhe argumentimin e tyre;

Etika dhe Komunikimi

- Të shpjegojë komunikimin etik dhe rëndësinë e tij në animacionin social;
- Të përshkruajë konceptet bazë të etikës dhe vlerave në fushën e shërbimit social;
- Të përshkruajë teknikat dhe modelet e komunikimit sipas rrethanave të ndryshme;
- Të përcaktojë llojin e komunikimit sipas mjedisit përkatës dhe veçorive individuale të grupit të synuar
- Të përshkruajë rëndësinë e formulimit të qartë dhe me fraza të thjeshta;
- Të shpjegojë rëndësinë e ruajtjes së mjedisit si mënyre jetese në komunitet;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e zbatimit të rregullave në lidhje me etikën, konfidencialitetin dhe diskrecionin profesional gjatë ushtrimit të detyrës;

- Të përshkruajë domosdoshmërinë e zhvillimit profesional për të koordinuar dhe lehtësuar ofrimin e shërbimeve sociale;
- Të përshkruajë domosdoshmërinë e njohjes së rrjetit profesional të partnerëve të jashtëm;
- Të përshkruajë domosdoshmërinë e sigurimit të komunikimit efektiv dhe ndjekjes së veprimtarive për të përfituar nga përvoja e njëri-tjetrit;
- Të përshkruajë parimet e përgjithshme të komunikimit ndërpersonal dhe ndërinstitutional;
- Të listojë parimet e ndërhyrjes në menaxhimin e konflikteve;
- Të shpjegojë përdorimin e teknikave të menaxhimit të konflikteve dhe situatave të vështira;

SHPREHI PROFESIONALE

Individi duhet të jetë i aftë:

Sfondi i përgjithshëm profesional në animacion

- Të përzgjedhë pajisjet e punës sipas aktivitetit social;
- Të mirëmbajë pajisjet specifike sipas vendeve përkatëse;
- Të përzgjedhë dhe përdorë një tërësi materialesh, duke përfshirë balta të modelimit, bojëra uji, akrilikë etj.;
- Të përdorë suportet teknike në funksion të një aktiviteti social të caktuar;
- Të organizojë në mënyrë ergonomike vendin e punës;
- Të përcaktojë objektivat e punës;
- Të ndajë detyrat dhe rolet në një aktivitet social;
- Të parandalojë situata problematike përpara se ato të ndodhin;
- Të analizojë grupin pjesëmarrës, përshtatjen e moshës apo/dhe kushtet fizike;
- Të hartojë një program social;
- Të prezantojë një program social;
- Të përshtatë programin në kushte të paparashikuara (p.sh. moti, siguria etj.);
- Të krijojë një aktivitet social për grupmosha të ndryshme;
- Të demonstrojë aftësitë e përfutuara të punës në grup;
- Të respektojë standardin e profesionit;

Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit

- Të respektojë normat e sigurisë në lidhje me aktivitete të ndryshme sociale;
- Të menaxhojë situatat e rrezikshme gjatë një aktiviteti social;
- Të organizojë dhe zbatojë një plan menaxhimi të rreziqeve të ndryshme në një aktivitet social;
- Të respektojë rregullat e higjienës personale, si dhe të higjienës në vendin e punës ;
- Të respektojë rregullat për mbrojtjen e mjedisit;
- Të prezantojë rëndësinë e ruajtjes së mjedisit si mënyrë jetese në komunitet;

Krijimi i një kontakti, marrëdhënieje të përshtatshme me përfituesin e shërbimit social, familjen, rrethin shoqëror

- Të zhvillojë një platformë komunikimi me përfituesin e shërbimit;
- Të prezantojë shërbimet, duke shpjeguar rolin e tij/saj në këtë shërbim;
- Të dëgjojë me vëmendje përfituesin e shërbimit social, mjedisin të tij (familjar, shoqëror), duke aplikuar parimet themelore të dëgjuarit aktiv;
- Të evidentojë kërkesat/nevojat e thëna/paraqitura dhe të nënkuptuara;
- Të analizojë situatën e klientit duke u mbështetur në psikologjinë, marrëdhëniet, komunikim, etj.;
- Të përdorë instrumente për të lehtësuar vetëvlerësimin e klientit (aftësitë, potencialin e tij/saj);

Teknikë e animimit

- Të dallojë teknikat e përdorura në varësi të aktivitetit social;
- Të prezantojë veten dhe pjesëtarët e një grupi te caktuar;
- Të prezantojë dhe te përcaktojë objektivin dhe qëllimin e aktivitetit social;
- Të përgatisë pyetësorë me qëllime ndërveprimi të pjesëmarrësve në aktivitet;
- Të zhvillojë teknika ‘’thyerje-akulli’’ (shaka, histori komike, etj.) me qëllim krijimin e një klime sa më të mirë bashkëpunimi;
- Të respektojë kohën që i duhet për zbatimin e një projekti ose programi social;
- Të përzgjedhë teknikën e duhur në funksion të aktivitetit social, në varësi të hapësirës dhe kohës në dispozicion;
- Të kërkojë forma të reja të teknikave të animacionit;
- Të menaxhojë energjinë dhe dinamizmin e grupit pjesëmarrës;
- Të animojë në mënyre të pavarur grupe te ndryshme sipas nevojave të tyre;
- Të drejtojë dhe te marrë përgjegjësitë e një aktiviteti në mënyrë dinamike dhe aktive;
- Të improvizojë në rrethana të ndryshme gjatë aktivitetit;
- Të bashkëpunojë me përgjegjësi dhe efektivitet me interpretues dhe kontribuues të tjerë në zhvillimin e një projekti social;
- Të zbatojë teknika të ndryshme animimi në funksion të aktivitetit social në varësi të hapësirës në dispozicion;

Psikologjia

- Të vlerësojë progresin e një individi ose grupi shoqëror në një komunitet;
- Të analizojë marrëdhëniet midis grupmohave dhe komuniteteve të ndryshme;
- Të kuptojë nevojat e pjesëmarrësve të ndryshëm (duke përfshirë ata me nevoja të veçanta) në aktivitet;
- Të ndërtojë marrëdhënie midis individëve ose grupeve shoqërore;
- Të komunikojë me efikasitet me pjesëmarrësit në të paktën një gjuhë të huaj;
- Të reagojë në mënyrë konstruktive ndaj sjelljeve të ndryshme nga ana e pjesëtarëve të një komuniteti të caktuar;
- Të menaxhojë në mënyrë konstruktive sjelljet e ndryshme nga ana e pjesëtarëve të

një komuniteti të caktuar;

- Të demonstrojë vetë-motivim, iniciativë dhe disiplinë të nevojshme për të ofruar projekte kreative në përputhje me buxhetin dhe kohën në dispozicion;
- Të demonstrojë mendje hapësi dhe të ekzaminojë në mënyrë kritike informacionin;
- Të mbështesë dhe nxisë pjesëmarrjen aktive të grupit të synuar përmes proceseve motivuese të përfshirjes;

Gjenerimi i ideve/modeleve të animacionit social

- Të përcaktojë llojin e informacionit sipas nevojave dhe interesave të grupmoshave të caktuara;
- Të përcaktojë burimet e informacionit të nevojshme sipas tematikës/programit social;
- Të menaxhojë mënyrat e përpunimit të informacionit sipas tematikës/programit social;
- Të identifikojë burimet e ndryshme të informacionit në përputhje me programin;
- Të dizajnojë modele, sfonde, karaktere dhe objekte për një projekt animacioni të caktuar;
- Të dizajnojë në konsultë me të tjerë mjedisin animues;
- Të demonstrojë origjinalitet në aplikimin e njohurive dhe teknikave të reja për një problem krijues;
- Të eksperimentojë në përdorimin e materialeve, proceseve dhe hapësirave për të përkthyer idetë në një shfaqje animacioni;
- Të planifikojë, monitorojë dhe raportojë për mbarëvajtjen e projektit social, me qëllim gjetjen e mundësive për vetë përmirësim, si dhe për zhvillim të qasjeve personale për krijim;

Etika dhe Komunikimi

- Të raportojë, me gojë ose me shkrim duke përdorur një fjalor "profesional";
- Të zhvillojë një sistem komunikimi të përshtatshëm me përfituesit, duke marrë parasysh kufizimet e secilit person;
- Të prezantojë zgjidhje të një problemi pa e imponuar atë;
- Të përdorë teknika të ndryshme negocimi pa imponuar zgjidhjen e tij;
- Të zbatojë rregullat etike lidhur me veprimtarinë e punës;
- Të respektojë rregullat e konfidencialitetit;
- Të formulojë qartë dhe me fraza të thjeshta;
- Të përdorë mjete pamore për të lehtësuar kuptimin;
- Të komunikojë duke përdorur shembuj konkret;
- Të komunikojë me efikasitet me pjesëmarrësit në të paktën një gjuhë të huaj;
- Të demonstrojë iniciativë, korrektësi, sinqeritet, kreativitet, zbatueshmëri të afateve kohore dhe vetëkontroll;
- Të punojë në ekip duke bashkëpunuar me sektorët e tjerë;
- Të respektojë komunikimin sipas hierarkisë;

- Të zbatojë orarin e punës dhe detyrat sipas përshtimit të vendit të punës.

KOMPETENCA TË PERGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij/saj;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënës të tij/saj dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kriteret e drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij/saj;
- Të demonstrojë sjellje dhe qëndrime etike në veprimtaritë shkollore dhe në komunitet;
- Të demonstrojë aftësinë për të pranuar dhe promovuar ndryshimin dhe inovacionin;
- Të demonstrojë aftësinë për të komunikuar dhe negociuar idetë në mënyrë efektive me të tjerët;
- Të demonstrojë aftësinë për të menduar në mënyrë krijuese dhe novatore;
- Të demonstrojë aftësinë për të identifikuar dhe për të zgjidhur në mënyrë krijuese problemet.